




REPUBLIKA E SHqipërisë
MINISTRIA E ZHVILLIMIT
EKONOMIK, TURIZMIT
TREGTISË DHE SIPËRMARRJES
MINISTRI



URDHËR

Nr 1772 datë 5.4. 2017

PËR

**“PËR NJË SHITESË DHE DISA NDRYSHIME NË URDHËRIN NR. 1556/1 DATË 30.03.2016
“PËR MIRATIMIN E NUMRIT DHE PËRHAPJES NË TERRITOR TË SPORTELEVE TË
QENDRËS KOMBËTARE TË BIZNESIT””**

Në mbështetje të pikës 3 të nenit 16 të ligjit nr. 131/2015 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, si dhe shkresës nr.805/3, datë 01.03.2017 të Qendrës Kombëtare të Biznesit “Mbi vlerësimin e mundësisë së hapjes së sportelit të QKB-së në Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë, Qarku Fier”,

URDHËROJ:

1. Ndryshimin dhe shtimin e sportelit të QKB-së në Qarkun Fier, si vijon:

QARKU	NR.	VENDNDODHJA
Fier	14	Fier
	15	Lushnje
	16	Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Fier

2. Ndryshimin e renditjes numerike të sporteleve të parashikuara në Urdhrin Nr.1556/1 datë 30.3.2016 “Për miratimin e numrit dhe përhapjes në territor të sporteleve të Qendrës Kombëtare të Biznesit”, nga 16 dhe vijues, referuar pikës 1 të këtij Urdhri.
3. Ndryshimin e numrit total të sporteleve në territor nga 33 në 34.
4. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Qendra Kombëtare e Biznesit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

